Republika e Kosovës – Republika Kosova
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.503/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP),** në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Afijete Sada - Gllogjani dhe Rrustem Thaqi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën Romani Iniciativa të paraqitur kundër Komisionit Qendror te Zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë.16.02.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** e pa lejuar ankesa Anr.503/2021, e datës 15.02.2021, e parashtruar nga Romani Iniciativa, për shkak te parregullsive dhe gabimeve teknike në regjistrimin e votave.

**A r s y e t i m**

Me datën 15.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesen Anr.503/2021, me te cilen pretendojn se me rezultatet në vendvotimin 3409E/02D, ka ndidhur një gabim në evidentimin e votave. Parashtruesi i ankeses konsideron se në rezultatin zyrtar i cili është publikuar në ueb faqen e KQZ-së, ka ndodh një gabim teknik te numr i votave të Iniciativës sonë. Nga rezultatet e shpallura, lista zgjedhore LPRK me numër 123 ka fituar 47 vota, ndërsa Romani Iniciyativa (RI) ka zero (0) vota. Ne konsiderojmë se ka ardhur deri te një gabimi teknik me rastin e shënimit e të dhënave, sepse sipas informatave tona Romani Iniciativa në këtë vendvotim ka fituar 47 vota.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

**Ankesa është e pa lejuar**

Paneli nuk është lëshuar fare vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkitazi me parregullsit e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ti hedh si të parakohshme ankesat e ankueses. Hudhja e ankesave të ankueses nuk e paragjykon çështjen se ankueses i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se "*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet*" dhe Nenit 6.4 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *"Ankesat të cilat janë të palejuar dhe te pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim"*, lidhur me ankesën e lartë PZAP-i vlerësoj se ankesa e ankueses është e palejuar për faktin se PZAP-i nuk mundi të veproj sipas ankesës së ankueses, në kuptim të nenit te lartëcekur.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**
**Anr.503/2021 më datën 16.02.2021**

**Kryesuese e Panelit**
Milena Derić

**Këshillë juridike**: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP*